



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.190/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik koalicionit NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 04.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.190/2019 e datës 02.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik koalicionit NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Organizata Joqeveritare BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP më datë 02.10.2019, me të cilën pretendon se me dt. 1 tetor 2019, rreth orës 19:30, ka vërejtur, një fëmijë me flamur në dorë, në një video të shpërndarë me dt. 30.09.2019, në rrjetin social Facebook, nga ajo video janë nxjerrë fotografi nga organizata Joqeveritare BIRN dhe IKS, me të cilat veprime paraqitësi i ankesës pretendon se është shkelur Rregulla Zgjedhore Nr.13/2013, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregullën Zgjedhore Nr.20/2019, për “*Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike*”, respektivisht neni 5 par.3 dhe b) i rregullës në fjalë.

Paraqitësi i ankesës si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur disa fotografi.

Në përgjigje në ankesë të datës 03.10.2019, subjekti politik koalicioni NISMA-AKR-PD, lidhur me pretendimet ankimore të Organizatës Joqeveritare BIRN dhe IKS, ka theksuar se ata nuk konsiderojnë se nga ana e tyre është bërë ndonjë shkelje e cila bie ndesh me dispozitat e LZP-së, duke shtuar se pamjet në foto për pjesëmarrjen e fëmijëve në fushatë zgjedhore në rastin konkret nuk dëshmojnë moshën e tyre, dhe se kjo ankesë është e mangët, ngase nuk jep sqarime e as prova të sakta, se nga cila faqe e rrjetit social facebook, është nxjerre, kjo fotografi, dhe se kush e ka postuar dhe në cilën kohë shihet ky fëmijë në video.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se paraqitësi i ankesës nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme për t'i argumentuar pretendimet e veta. Nga provat e bashkangjitura ankesës nuk mund të arrihet deri te vërtetimi i pretenduesit të ankesës, se në fushatën janë përdorur fëmijët nën moshën 15 vjeçare, andaj në mungesë të provave bindëse, paneli nuk mund të vendos me hamendje, dhe me këtë rast ankesën e ankuesit e refuzoi të pa bazuar, krejt kjo bazuar në nenin 117 paragraf 3 i LZP-së.

Pretendimet ankimore të paraqitësit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregullën Zgjedhore Nr.20/2019, për "Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike", respektivisht nenin 5 paragraf 3 pikab) të rregullës në fjalë, nga ana e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe IKS, Paneli vlerësoi se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore, me të cilat sanksionohet pjesëmarrja në fushatë zgjedhore e personave të cilët nuk i kanë mbushur 15 vjeç. Andaj në mungesë të provave, paneli e refuzoi ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë.

Paneli në kuptim të nenit 115.1 dhe neni 118 paragraf 1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.190/2019 më datën 04.10.2019

Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së / Prishtinë